



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR**

# **Analiza Vjetore 2019**

**ANALIZA E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË  
PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR PËR PERIUDHËN  
JANAR – DHJETOR 2019**

**Janar 2020**

## *PËRMBAJTJA*

<b>I. Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit të Prefektit të qarkut.....</b>	<b>4</b>
<b>II. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore.....</b>	<b>9</b>
1. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore që janë depozituar në zyrën e protokollit të institucionit të Prefektit.....	9
2. Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.....	11
3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të bazueshmërisë ligjore të akteve.....	12
<b>III. Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me degët territoriale dhe institucionet shtetërore në nivel vendor.....</b>	<b>13</b>
1. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.....	13
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë.....	13
3. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë.....	14
4. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.....	16
5. Dega e Doganës Kakavie.....	17
6. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.....	18
7. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Gjirokastrë.....	19
8. Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë.....	20
9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë .....	20
10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.....	21
11. Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Jugor.....	22
12. OSHEE Drejtoria Rajonale Gjirokastrë .....	22
13. ZVA Gjirokastrë-Libohovë-Dropull.....	23
14. ZVA Tepelenë-Memaliaj.....	24
15. ZVA Përmet-Këlcyrë.....	25
16. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore.....	26
17. Sektori i Ekstensionit Bujqësor Gjirokastrë.....	27
18. Sektori i Bordit të Kullimit Gjirokastrë .....	28
19. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë.....	28
20. Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë “Omer Nishani” .....	29

21. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër.....	30
22. Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Gjirokastër.....	31
23. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër.....	32
24. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura.....	34
25. Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.....	35
26. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Gjirokastër.....	36
IV. <b>Investimet kryesore në qarkun Gjirokastër.....</b>	<b>37</b>
V. <b>Mbrojtja Civile në qark.....</b>	<b>38</b>
VI. <b>Task Forcat, Komitetet Rajonale si dhe Organi Këshillues pranë Prefektit të qarkut.....</b>	<b>39</b>
VII. <b>Rekomandime.....</b>	<b>41</b>
VIII. <b>Objektivat për vitin 2020.....</b>	<b>42</b>

## **I. Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit të Prefektit të qarkut**

**N**ë veprimtarinë e tij të punës një-vjeçare, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka funksionuar dhe ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrive të linjës, në drejtim të garantimit të zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësi gjatë vitit 2019, ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka intensifikuar punën lidhur me bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të institucioneve dhe drejtues të NJVV, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2019, institucioni i Prefektit të qarkut ka intensifikuar punën në drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë. Po kështu institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar veprimtarinë dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjelltë të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Në fillim të vitit 2019, janë hartuar planet vjetore sektoriale të punës dhe janë përcaktuar objektivat e institucionit të Prefektit të qarkut. Në muajin janar të vitit 2019 është hartuar dhe miratuar plani vjetor i punës së institucionit të Prefektit të qarkut si dhe janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat e sektorëve dhe të gjithësecilit për realizimin me sukses të të gjithë veprimtarisë së institucionit. Gjatë vitit 2019, me prioritet të veçantë janë trajtuar dhe ndjekur të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të adresuara pranë Prefektit të qarkut. Problematikat dhe shqetësimet e qytetarëve kanë pasur të bëjnë me shërbime të ndryshme dhe detyrime për organet e vetëqeverisjes vendore dhe një numër i konsiderueshëm i tyre për institucionet rajonale vendore.

Një nga shërbimet që institucioni i Prefektit ofron për qytetarët është legalizimi i dokumenteve të lëshuara për përdorim jashtë vendit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total përgjatë vitit 2019 numri i legalizimeve ka qenë 18 780. Numri i dokumenteve të legalizuara përgjatë vitit 2019 ka njohur një rritje me 25% krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, në Protokollin e institucionit të Prefektit kanë hyrë 1 530 shkresa (kërkesa, ankesa), kanë dalë 886 shkresa (përgjigje) dhe janë përgatitur 142 urdhëra të firmosura nga Prefekti i qarkut.

Një vëmendje e veçantë iu është kushtuar ankesave të qytetarëve, të cilat i janë adresuar për zgjidhje njësisive të vetëqeverisjes vendore. Nga të gjitha ankesat e trajtuara, të cilat lidhen me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo vendimmarrjen e këshillave bashkiakë, vihet re se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë zgjidhjen ligjore, por kërkohet një angazhim më i madh nga ana juaj për rritjen e shërbimit ndaj komunitetit dhe dhënien e zgjidhjes përfundimtare të problematikave të tyre.

Në zbatim të ligjit për Prefektin, të akteve të tjera ligjore dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2019, janë ngritur dhe kanë funksionuar disa Task-Forca në nivel vendor për problematika të ndryshme, veçanërisht këto në shërbim të komunitetit.

Bazuar në urdhërin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë nr. 9, datë 25.01.2018 “Për krijimin e komisionit të nxjerrjes dhe asgjësimit të dokumentave me karakter të thjeshtë”, ky komision ka bërë të mundur asgjësimin me djegie të dokumenteve të sektorit të financës me masë lineare 1.81ml, me Vendimin Nr.01, datë 04.02.2019, evidentuar në librin e Protokollit me nr. 214. Gjatë vitit 2019 nga ana e specialistit të protokoll arkivës u bë i mundur dorëzimi i dokumentacionit në Arkivën Vendore të Lushnjës, i cili kishte mbushur afatin e maturimit për vitet 1995-2004 me R.H.K. duke realizuar kështu objektivin e vënë për këtë vit dhe detyrën e lënë nga Drejtorja e Inspektimit dhe Trajnimeve.

Viti 2019 ka qenë edhe vit zgjedhor për zgjedhjet e pushtetit vendor. Në këtë kuadër, Prefekti i qarkut morri masa për plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor, ligji 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” dhe ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Është dërguar shkresa pranë çdo bashkie për përcaktimin e numrit të anëtarëve të këshillit bashkiak për çdo bashki si dhe pranë Këshillit të Qarkut për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Këshillit të Qarkut.

Institucioni i Prefektit të qarkut ka punuar me dy Draft-Udhëzime për procedurat e konstituimit të organeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore, të cilat u dërguan pranë Ministrisë së Brendshme dhe u miratuan si udhëzim për të gjithë Prefektët dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Pas daljes së rezultatit zyrtar, Prefekti realizoi një takim me sekretarët e këshillave bashkiakë për organizimin e mbledhjeve të para të konstituimit dhe ka ndjekur e monitoruar të gjitha mbledhjet e konstituimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Për ecurinë e të gjithë procesit para dhe pas zgjedhor është informuar në mënyrë të hollësishme Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme. Në muajin gusht, Prefekti i qarkut organizoi një takim me kryetarët e bashkive të dala nga zgjedhjet e qershorit, ku ishte e pranishme dhe zv. Ministria e Brendshme znj. Romina Kuko. Në këtë takim u diskutua mbi bashkëpunimin mes institucionit të Prefektit të qarkut dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Në zbatim të ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, të akteve të tjera ligjore dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut gjatë 9-mujorit të parë të

vitit 2019 janë ngritur dhe kanë funksionuar disa Task-Forca në nivel vendor për problematika të ndryshme, veçanërisht këto në shërbim të komunitetit.

Viti 2019 përkonte me jubileun e 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Prefekti i qarkut, në muajin janar 2019 ka kërkuar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degëve territoriale, kalendarin e festave zyrtare dhe aktiviteteve, për të përcaktuar axhendën e festimeve. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit është ngritur Komisioni Vendor për Përkujtimin e 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Në këtë kuadër, Prefekti i qarkut në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni në bashkëpunim me kryetarët e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe drejtues të institucioneve në qark, organizatave të veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve kanë organizuar një sërë veprimtarish, të cilat kulmuan me Konferencën Shkencore Kombëtare “Prefektura Gjirokastrë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944”. Prefekti i qarkut, në bashkëpunim me Universitetin “Eqrem Çabej” ka realizuar një botim me kumtesa, ku përfshihet e gjithë veprimtaria e qarkut gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në fund të muajit nëntor të vitit të kaluar, vendi ynë u përball me një nga fatkeqësitë më të mëdha natyrore, ku kryesisht u prekën qarqet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës. Përveç dëmeve të mëdha materiale pati dhe një numër të konsiderueshëm viktimash. Prefekti i qarkut i ka bërë një thirrje të hapur të gjitha NJVV dhe degëve territoriale për dhënie ndihme të menjëhershme dhe solidarizim me të dëmtuarit. Prefekti i qarkut vlerëson gatishmërinë e treguar të institucioneve dhe kontributin e dhënë nga gjithë qarku i Gjirokastrës. Marrë shkas nga kjo ngjarje e ndodhur, Prefekti i qarkut ka kërkuar nga NJVV rivlerësimin e situatës ndërtimore në qarkun e Gjirokastrës, gjë e cila nuk është përmbushur nga të gjitha bashkitë e qarkut.

Gjatë kësaj periudhe, në mënyrë sistematike nga ana jonë është raportuar çdo javë dhe çdo muaj pranë Zyrës Operacionale të Situatës në Kryeministri, Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe Funksioneve të Deleguara pranë Ministrisë së Brendshme si dhe në ministritë e tjera të linjës për veprimtarinë, problematikat dhe realizimet e detyrave në rang qarku të institucionit të Prefektit të qarkut.

Në zbatim të planit të auditimit për vitin 2019, miratuar nga Ministri i Brendshëm me urdhrin nr.501 datë 22.10.2018 “Për miratimin e Planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019”, gjatë kësaj periudhe është kryer auditimi i veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë për periudhën 01.01.2018 deri më 31.03.2019. Auditimi kishte si qëllim vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, përputhshmërinë e veprimtarisë me aktet ligjore e nënligjore, vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit, evidentimin e mangësive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen.

Në rregulloren e institucionit të Prefektit të qarkut të hartuar dhe të miratuar, pavarësisht ndonjë mangësie apo mospërshtatje, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe të qartë detyrat dhe funksionet e çdo sektori në përgjithësi dhe të çdo specialisti në veçanti. Së shpejti do të miratohet edhe rregulloja tip për të gjithë prefekturat çka do të saktësojë dhe do të rregullojë edhe ndonjë mangësi të konstatuar nga ana e kontrollit të auditit.

Përsa i përket realizimit të buxhetit për vitin 2019, prej institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë është synuar zbatimimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe respektimit të parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve. Ndjekja e çmimeve të tregut dhe përlllogaritja e kostove për çdo prokurim të realizuar për blerjet me vlerë të vogël, ka bërë që shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera të realizohet duke plotësuar nevojat e institucionit. Me miratimin e buxhetit për vitin 2019, nga ana jonë u bë detajimi i fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2019, duke paraqitur sa më saktë nevojat e institucionit të Prefektit për të dy programet. Si për programin e Prefekturës ashtu dhe për programin e Gjendjes Civile. U përpilua regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2019 me 13 (trembëdhjetë) objekte prokurimi, mbi bazën e të cilit janë realizuar 10 (dhjetë) prokurime publike të blerjeve me vlerë të vogël, një procedurë prokurimi “Kërkesë për Propozim” për blerje pajisje zyresh, e realizuar, një procedurë prokurimi “Prokurim i Përqëndruar” e realizuar nga Agjensia e Prokurimeve të Përqëndruara, pranë Ministrisë së Brendshme për blerje “Karburant dhe Vaj” dhe një procedurë prokurimi blerje me vlerë të vogël “Të tjera materiale dhe shërbime speciale” e pa realizuar për arsye se fondi i llogaritur u transferua për likuidimin e faturës së energjisë elektrike të mbartur ndër vite.

### Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2019.

Struktura : Gr. 16 Titull 01160, Kap.1

( Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë )

*në lekë*

Art.	N/Art.	Emertimi i Shpenzimeve sipas strukturës Buxhetore	Plan 2019	Fakt 2019	%
600		<b>PAGA, SHPERBLIME DHE TE TJERA SHPENZIME PERSONELI</b>	<b>22.087.860</b>	<b>21.892.844</b>	<b>99%</b>
601		<b>KONTRIBUTI PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE</b>	<b>3.700.000</b>	<b>3.549.406</b>	<b>96%</b>
602		<b>MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA</b>	<b>5.943.190</b>	<b>5.915.088</b>	<b>100%</b>
	602,0	Materiale dhe sherbime zyre te pergjithshme	406.000	404.880	100%
	602.1	Materiale dhe sherbime speciale	99.000	99.000	100%
	602.2	Sherbime nga te tretet	1.711.190	1.699.761	99%
	602.3	Shpenzime transporti	1.612.000	1.608.457	100%
	602.4	Shpenzime udhetimi	1.500.000	1.499.850	100%
	602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	90.000	87.522	97%
	602.6	Shpenzime per qeramarrje	300.000	291.050	97%
	602.7	Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale	0	0	0%
	602,9	Shpenzime te tjera operative	225.000	224.568	100%
604	604.0009	Shpenzime per funksione kushtetuse	0	0	0%
606	606	Transferta per buxhete familjare dhe individe	579.540	579.540	100%
231	231	Shpenzime per investime	5.681.000	3.648.699	64%
<b>T O T A L I</b>			<b>37.991.590</b>	<b>35.585.577</b>	<b>94%</b>

Me qëllim menaxhimit financiar dhe eficient të fondeve të buxhetit të Prefekturës së qarkut Gjirokastrë, për të dy programet, si dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të palikuiduara në kohë, për vitin 2019, janë marrë të gjitha masat për evidentimin e çdo detyrimi, duke verifikuar saktësinë e faturave, dokumentacionin justifikues të çdo fature dhe likuidimin e tyre në kohë.

Prioritet i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse ka qenë garantimi, para miratimit të Urdhrave me karakter financiar, i zbatimit të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe respektimit të parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve. Ndjekja e çmimeve të tregut dhe përlllogaritja e kostove për çdo prokurim të realizuar për blerjet me vlerë të vogël, ka bërë që shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera të realizohet duke plotësuar nevojat e institucionit.



## II. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore


**M**arrëdhëniet midis Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” dhe në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie. Marrëdhëniet ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

### 1. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore që janë depozituar në zyrën e protokollit të institucionit të Prefektit


Në zbatim të kompetencave që i njeh ligji 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, Prefekti i qarkut Gjirokastrë edhe gjatë vitit 2019 ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore duke zbatuar procedurën e parashikuar në nenin 16 të ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. Për të gjitha vendimet e depozituara pranë zyrës së protokollit të institucionit të Prefektit është bërë verifikimi dhe është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.

Për vitin 2019 nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat përfshihen në qarkun Gjirokastrë janë paraqitur për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut Gjirokastrë gjithsej 600 akte nga të cilat janë konfirmuar si të bazuara në ligj 564 (rreth 94%) dhe janë kthyer të pakonfirmuar 36 (rreth 6%).




Nga evidenca e akteve rezulton se njësitë me numrin më të vogël të vendimeve të pakonfirmuara janë Këshilli i Qarkut me asnjë vendim të pakonfirmuar, bashkia Dropull me 1.5% dhe bashkia Libohovë me 2.8% të vendimeve të pakonfirmuara.

Njësitë me numrin më të madh të akteve të pakonfirmuara janë bashkia Memaliaj me 15 % dhe bashkia Përmet me 8.2 % të akteve të pakonfirmuara.



Krahasimisht me vitin 2018 vihet re një numër më i vogël aktesh të paraqitura nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, por gjithashtu edhe një përqindje më e vogël e akteve të kthyer të pakonfirmuara. Konkretisht në vitin 2018 nga totali i akteve të paraqitur për konfirmim nuk janë konfirmuar 13% e akteve, ndërsa në vitin 2019 nuk kanë marrë konfirmimin e Prefektit 6% e akteve të paraqitura.



Aktet e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë paraqitur për verifikim të ligjshmërisë kanë patur për objekt:

- Miratimi i buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Miratimi i paketës fiskale.
- Numri i strukturave organike.
- Niveli i pagave për punonjësit e njësive vendore.
- Miratim, ndryshim e përdorim fondesh.
- Dhënie ndihmë ekonomike dhe ndihmë paaftësie.
- Dhënie bursa për studentë dhe nxënës.
- Në fushën e zhvillimit urban.
- Nisma për hartimin apo rishikimin e planeve të përgjithshme vendore.
- Përcaktimin e venddepozitimeve të mbetjeve urbane.
- Trajtimi i rasteve të emergjencës etj.

Disa nga arsyet e moskonfirmimit të akteve, për shkak të papajtueshmërive ligjore kanë qenë:

- Mosnjohja e akteve ligjore e nënligjore në lidhje me çështjet e trajtuara.
- Zbatimi jo i saktë i ligjit.
- Pasaktësi në anën formale të aktit.

Në çdo rast të kthimit të pakonfirmuar të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, nga ana jonë është bërë argumentimi ligjor i papajtueshmërive të konstatuara.

Tërheqim vëmendjen e drejtuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët kanë detyrimin ligjor të paraqitjes dhe miratimit të vendimit për buxhetin e bashkisë deri në datë 25 dhjetor. Kemi konstatuar se si për vitin 2019 ashtu edhe për vitin 2020 jo të gjitha bashkitë e kanë repektuar këtë afat.

## **2. Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore**

Gjatë vitit 2019 është realizuar procesi i verifikimit të ligjshmërisë së akteve të vetëqeverisjes vendore në vend në zbatim të nenit 17 të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. Është ngritur grupi i punës me urdhrin nr. 28, datë 29.03.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2019”.

Është realizuar verifikimi i ligjshmërisë në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, përkatësisht tre verifikime në secilën njësi. Verifikimi i katërt do të kryhet brenda muajit janar 2020.

<b>Nr.</b>	<b>Njësia e vetëqeverisjes vendore Këshilli i bashkisë</b>	<b>Akte të verifikuara në vend Janar – Dhjetor 2019</b>
1.	Këshilli i Qarkut	26
2.	Gjirokastrë	104
3.	Dropull	50
4.	Libohovë	89
5.	Tepelenë	73
6.	Memaliaj	46
7.	Përmet	55
8.	Këlcyrë	71
9.	Gjithsej	514

Janë verifikuar gjithsej 514 akte. Nga verifikimi është konstatuar se nuk ka patur akte normative (vendime) të këshillave bashkiakë të padepozituara pranë institucionit të Prefektit.

Në përgjithësi, vendimet për të cilat është bërë konfirmimi ligjor kanë qenë të bazuara në ligj dhe procedura për marrjen e këtyre vendimeve ka qenë e rregullt e në përputhje me ligjin. Nuk ka patur problematika për t’u evidentuar apo për të ndjekur procedurën e parashikuar nga Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, neni 17, pika 2.

Është konstatuar në disa raste se dokumentacioni i mbajtur nga ana e sekretarëve të këshillave për pasqyrimin e vendimmarrjes së këshillit ka qenë me pasaktësi. Në këto raste janë lënë rekomandimet përkatëse, të cilat në pjesën më të madhe janë reflektuar në vazhdimësi sipas konstatimeve të verifikimeve të mëvonshme.

### 3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të bazueshmërisë ligjore të akteve

Vëmendje i është kushtuar bashkëpunimit me sekretarët e këshillave të bashkisë në lidhje me përmirësimin e punës së tyre dhe rritjes së bazueshmërisë ligjore të akteve të këshillave të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Komunikimi me sekretarët ka qenë i vazhdueshëm dhe rast pas rasti, me qëllim konsultimin në drejtim të përmirësimit të punës dhe rritjes së cilësisë së akteve të tyre si nga pikëpamja e përmbajtjes dhe bazueshmërisë së tyre në ligj ashtu edhe nga ana formale.

Në këtë kuadër, në datë 18.12.2019 është organizuar një takim me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistë të njësisve të vetëqeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e punës në lidhje me procedurën e verifikimit të akteve të organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Nisur edhe nga problematikat e konstatuara, ky takim ishte konceptuar si një mini-trajnim për të shpjeguar dhe standardizuar mënyrën e paraqitjes së akteve për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut, elementët formal dhe të përmbajtjes që këto akte duhet të përmbushin në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe u bë një prezantim dhe interpretim i bazës ligjore që duhet të zbatohet nga sekretarët e këshillave, por edhe specialistët e tjerë pranë bashkive.

Lidhur me buxhetin, realizimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimet e kryera prej NJVV për vitin 2019 ju paraqesim të dhënat në tabelën më poshtë:

Nr.	Keshilli i Qarkut/Bashkia	Buxheti		Realizimi i te Ardhurave		Realizimi i Shpenzimeve		Realizimi i investimeve			Fondi emergjenca ve	ne %		
		2019	2020	2019		2020		2019		2020				
		Plan	Plan	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan				
1	Keshilli i Qarkut	62110	51730			51730			51730			17307	1200	2.32
2	Gjirokaster	731632	652116		179621	652116		323160	652116		79672	88524	9420	2
3	Tepelene	197560	207403	42099	35707	207403			207403	36721	31713	7460	11300	5.44
4	Permet	297084	307952			307952			307952	50594	36721	33093	5680	1.84
5	Memaliaj	327453	241582	29861	14028	241582	305312	282461	241582	47602	44051	37000	6800	2.81
6	Kelcyre	162000	140500			140500			140500	164482	113317	10000	2100	1.5
7	Dropull	226015	199978			199978			199978	45215	44921	44412	4500	2.25
8	Libohove	208360	142036	12869	11099	142036	130466	98570	142036	74992	64302	28653	2000	2.34

### **III. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me degët territoriale dhe institucionet shtetërore në nivel vendor**

**Kryeministria** ka në varësi:

Agjencinë e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara, Zyra Rajonale Gjirokastër  
Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër

#### **1. Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara**

Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara ka si mision ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të sporteve pritëse për qytetarët (front office) si dhe qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë (one-stop-shop).

Në ADISA-Gjirokastër që nga muaji Janar deri në Dhjetor, numri i aplikimeve ka qenë jo më pak se 79 019. Në Zyrën Rajonale Adisa Gjirokastër operojnë tashmë 9 institucione. Këto institucione realizojnë ofrimin e shërbimeve publike në 18 sportele + 3 specialistë shërbimi në Info Point.

Në vitin 2019 për shkak të interesimit të lartë është rritur numri i sporteve në shërbim të qytetarëve. Përkatësisht institucioni i ALEAT nga dy sportele operon me katër sportele në mënyrë që shërbimi i pasaportave dhe kartave të identitetit, në këtë periudhë fluksi për shkak të rinovimit të tyre, të jepet në kohë të shpejtë.

**Problematika:**

- ❖ Mosrespektimi i afateve ligjore për dhënie e shërbimit ndaj qytetarëve.
- ❖ Mungesë stafi.

#### **2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër**

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër ka si mision administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme; regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike; përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme.

Prej vitit 2018 ALUIZNI dhe ZRPP (Hipoteka) kanë funksionuar si një institucion i vetëm nën emrin Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Përgjatë vitit 2019 prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër:

- Janë pajisur me leje legalizimi në total për vitin 2019, 264 subjekte vetëdeklaruese për objektet në posedim të tyre.
- Janë kualifikuar për t'u legalizuar në total 400 objekte informale të vetëdeklaruar për legalizim.
- Është kryer aplikimi online (pa pagesë) për 267 leje legalizimi.
- Janë verifikuar në terren 449 objekte informale dhe 304 objekte të ndërtuar para vitit 1991.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje aplikime të prapambetura ndër vite, të trajtuara rast pas rasti me interesimin e qytetarëve.

- Lidhur me regjistrimin e lejeve të legalizimit, gjatë vitit 2019 për periudhën janar-dhjetor janë aplikuar online 187 aplikime, nga të cilat janë regjistruar 175 Leje Legalizimi, pra janë realizuar në masën 93.5%.
- Numri i AMTP-ve të trajtuara është 85 AMTP.
- Numri i Certifikatave të pronësisë për AMTP-të e trajtuara është 235 (sipas aplikimeve të qytetarëve).

#### Problematika:

- ❖ Dixhitalizimi i arkivës;
- ❖ Përmirësimi dhe unifikimi i Hartës Kadastrale;
- ❖ Mungesa e infrastrukturës logjistike.

#### Ministria e Brendshme ka në varësi:

Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë

Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin

### **3. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë**

Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë ka si mision garantimin i një mjedisi të sigurt për komunitetin nëpërmjet policimit me standardet më të larta të performancës, krijimit të një kulture bashkëkohore manaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar.

Përgjatë vitit 2019 prej Drejtorisë Vendore të Policisë:

- Janë evidentuar gjithsej 1 016 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 902 ose 88.8% e tyre.
- Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë evidentuar 167 më shumë ose 19.62% vepra penale më shumë.
- Janë penalizuar 1 136 shtetas si autorë të veprave penale, nga të cilët 158 të arrestuar në flagrancë, 96 të ndaluar, 846 në gjendje të lirë dhe 36 të shpallur në kërkim.
- Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, janë penalizuar 231 autorë më shumë, nga të cilët 34 të arrestuar më shumë.
- Arritja e zbulueshmërisë së kriminalitetit në masën 80%. Është realizuar dhe tejkaluar me 8.8% në raport me vitin 2018.
- Janë evidentuar gjithsej 163 vepra penale kundër personit, nga të cilat janë zbuluar 156 ose 95.7% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 156 vepra penale kundër pasurisë, nga të cilat janë zbuluar 92 ose 58.9% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 57 vepra penale në fushën e korrupsionit, nga të cilat janë zbuluar 53 ose 93% e tyre.

- Janë evidentuar gjithsej 92 vepra penale në fushën ekonomiko-financiare, nga të cilat janë zbuluar 88 ose 95.6% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 9 vepra penale në fushën e pastrimit të parave, të cilat janë zbuluar 100%.
- Janë evidentuar gjithsej 2 vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike, zbuluar 100%.
- Janë evidentuar gjithsej 51 vepra penale në fushën e narkotikëve, nga të cilat janë zbuluar 45 ose 88% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 57 vepra penale në fushën e trafikve të paligjshme, nga të cilat janë zbuluar 51 ose 89.4% tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 212 vepra penale të tjera (armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, v. penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit), nga të cilat janë zbuluar 201 ose 94.8% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 22 vepra penale ndaj dhunës në familje, nga të cilat janë zbuluar 22 ose 100% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 64 vepra penale për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, nga të cilat janë zbuluar 63 ose 98% e tyre.
- Janë evidentuar gjithsej 4 vepra penale të kryera nga Grup i Strukturuar Kriminal, nga të cilat janë zbuluar 4 ose 100% e tyre.

Bimë narkotike të kultivuara dhe të asgjësuara, gjithsej 5 830 bimë narkotike. Krahasimi me të njëjtën periudhë të viti të kaluar: 2 770 bimë narkotike ose 32.2% më pak.

Sipas mënyrës së identifikimit:

- 78% e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar me informacion policor.
- 0% e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar nga kontrolli i territorit.
- 12% e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar nga monitorimi ajror, prej te cilave 4.9% nga monitorimi ajror me helikopter dhe 7.19% nga monitorimi ajror i GdiFinancës.

Krahas reduktimit të ndjeshëm të bimëve narkotike, konstatohet rritje e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike me 21 vepra penale ose 51.2% më shumë por ka edhe rritje të forcës zbuluese me 29% më shumë. Janë penalizuar me arrestim në flagrancë dhe ndalim 74 autorë, nga të cilët 27 zyrtarë të administratës shtetërore.

Problematika:

- ❖ Eficenca jo në nivelin e pritshëm e Specialistëve të Policimit në Komunitet dhe Patrullës së Përgjithshme të Policisë në drejtim të kontrollit të territorit.
- ❖ Rritja e numrit të aksidenteve rrugore, duke evidentuar 18 raste më shumë se viti i kaluar, edhe pse numri i jetëve të humbura në to është reduktuar me 1 më pak se viti 2018.
- ❖ Bashkëpunimi jo efektiv nga ana e pushtetit vendor dhe institucioneve të tjera shtetërore, në drejtim të kontrollit të territorit dhe sidomos për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike.

- ❖ Problematikat e shfaqura në organet e drejtësisë, për shkak edhe të Veting-ut, duke shfaqur një politikë “të butë” penale, sidomos ndaj kultivuesve të bimëve narkotike.

**Ministria e Financës dhe Ekonomisë** ka në varësi:

Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë

Degën e Doganës Kakavijë

Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Gjirokastrë

Drejtorinë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Gjirokastrë

Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë

#### 4. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka si mision rritjen e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale; përmirësimin dhe sigurimin e shërbimeve më të mira për tatimpaguesit; luftën kundër informalitetit dhe fokusi në mirëadministrimin e të ardhurave.

- Për periudhën Janar- Dhjetor 2019 të ardhurat janë realizuar në masën 99 % krahasuar me planin 2018; Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një realizim prej 106 % ose + 173 432 mijë lekë në vlerë absolute.
- Borxhi në fund të vitit krahasuar me fillimin e tij ka rënë në masën -4%.
- Plan i kontroleve është realizuar në masën 100% nga këto 16 vizita fiskale dhe 30 kontrole të plota.

*Shërbimi i Tatimpaguesit, Tregues sasior mbi performancën vjetore të vitit 2019.*

Treguesit e performances sipas Planit Strategjik te DPT 2017-2021	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	29	37	41	53	37	58	29	24	67	419	28	23
Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	1	1	1	2	2	3	1	1	2	0	1	0
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	6	527	259	56	276	332	195	128	39	74	0	0
Numri i seminareve edukuese të realizuara	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	321	276	321	324	431	313	281	256	446	439	275	214



Duke krahasuar të dhënat e marra për vitin 2019 ka një rritje të subjekteve aktive në krahasim me vitin 2018. Konkretisht 199 subjekte aktive në 2018 dhe 244 subjekte aktive në 2019.

Subjektet me status pasiv për vitin 2019 kanë një rënie krahasuar me subjektet pasiv të vitit të kaluar 2018. Konkretisht 287 subjekte me status pasiv në 2018 dhe 200 subjekte pasiv në 2019.

Subjektet me status të Çregjistruar të vitit 2019 kanë një rënie krahasuar me subjektet e çregjistruar me vitin 2018. Konkretisht 399 subjekte të çregjistruar në 2018 dhe 303 subjekte janë çregjistruar në 2019.

Subjektet me status Kërkese për Çregjistrim të vitit 2019 kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me një rritje të lehtë krahasuar me subjektet e një viti më parë. Konkretisht 101 subjekte me status kërkesë për çregjistrim në 2018 dhe 118 subjekte me status kërkesë për çregjistrim në 2019.

## **5. Dega e Doganës Kakavie**

Dega e Doganës Kakavie ka si mision rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtarëve dhe subjekteve si dhe uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore.

- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor prej Degës së Doganës Kakavie janë realizuar të ardhura në masën 96%. Realizimi i të ardhurave për vitin 2019 ka qenë 12% më shumë se në vitin 2018.
- Lidhur me numrin e deklaratave doganore, për vitin 2019 numri i deklaratave të përpunuara ka qenë 20 938 ndërkohë që në vitin 2018 janë përpunuar 18 298 deklarata doganore.

Peshën më të madhe në realizimin e të ardhurave e zënë zhdoganimi i artikujve si: cigare, karburante, birrë (kryesisht nga Greqia), artikuj të ndryshëm ushqimorë, kafshë të gjalla (kryesisht nga Rumania dhe Bullgaria), fruta dhe perime etj.

Importuesit Kryesorë të Degës së Doganës Kakavie janë:

**AGNA-Shoqëri Anonime**

**ALFA ShA**

**Liu Joti 2012 Shoqëri Anonime**

**Resuli-Er ShA**

**Elka**

**Nardi Petrol**

**Joti ShA**

**Uji i Ftohtë Tepelenë**

**XH.F.KACOs SH.P.K**


### Problematika:

- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës për të krijuar një mjedis më të mirë kontrolli dhe shërbimi me qëllim përbalimin e fluksit në rritje të qarkullimit të mallrave dhe udhëtarëve;
- ❖ Plotësimi i strukturës organike me qëllim realizimin e detyrave të ngarkuara;
- ❖ Trajnimi i stafit doganor nëpërmjet kurseve/seminareve sipas profileve të punës.

## **6. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit**

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ka si mision zbatimin e politikave efektive të punësimit dhe zbutjen e papunësisë në rajon.

Bazuar në informacionet e marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastrë, gjatë vitit 2019 janë regjistruar 3 967 pu.pa nga 3 667 pu.pa që u regjistruan gjatë vitit 2018.




(grafiku tregon numrin e PUPA të regjistruar në vitin 2018 dhe 2019 )

Nëpërmjet programeve të qeverisë për hapjen e vendeve të reja të punës është bërë e mundur që gjatë kësaj periudhe të punësohen rreth 979 punëkërkuar të papunë nga 968 punësime të përcaktuara në objektivin rajonal në fillim të vitit 2019, nga të cilat:

- ✓ 587 të punësuar me ndërmjetësim
- ✓ 392 gjetën punë vetë

Sipas kategorive janë punësuar:

- ✓ 24 pu-pa që trajtoheshin me ndihmë ekonomike
- ✓ 47 pu-pa që trajtoheshin me pagesë papunësie
- ✓ 5 pu-pa PAK (Persona me Aftësi të Kufizuar)
- ✓ 18 pu-pa nga komuniteti rom/egjiptian



(grafiku tregon numrin e të punësuarve nga DRSHPK në vitin 2018 dhe 2019 )

## Problematika:

- ❖ Vështirësi për të gjetur fuqi punëtore për shkak të uljes së popullsisë në qarkun e Gjirokastrës;
- ❖ Mungesa e kulturës së punës.

## **7. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Gjirokastrë**

Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Gjirokastrë ka si mision ofrimin e kurseve dhe trajnimeve kualifikuese të fushave të ndryshme si sociale, ekonomike etj me qëllim uljen e papunësisë.

- Sipas të dhënave të marra nga DRFPP gjatë vitit 2019 kanë ndjekur kurset e formimit profesional 1 566 PuPa nga 623 të përcaktuara në objektiv.

Kurset e hapura zhvillohen në disa prej bashkive të rajonit që mbulon DRFPP:

*Gjirokastrë:* berber, guidë turistike, instalime dhe mirëmbajtje elektrike, instalime dhe mirëmbajtje hidraulike, kuzhinë, mobilieri, parukeri, pastiçeri, saldim, servis motori në automjetet e lehta, shërbim në bar dhe restorante, shërbime mikpritje hotelerie etj

*Libohovë:* kursi kuzhinë

*Përmet:* kursi kuzhinë, pastiçeri

*Tepelenë:* kurse muratimi dhe suvatimi, gurgdhendës, bojaxhi, punime pllakashtrimi, guidë turistike, instalim dhe riparim i kondicionierëve shtëpiakë

Para zhvillimit të kursit profesional të gjithë kursantët PU/PA ndjekin kursin START-SMART “Aftësi për të kërkuar punë dhe aftësi sociale”.

Disa të dhëna statistikore për vitin 2019 për kursin START-SMART janë si më poshtë:

Janë hapur 64 grupe me 767 të regjistruar prej të cilëve 330 femra:

- Gjirokastrë 37 grupe
- Tepelenë 16 grupe
- Përmet 11 grupe

Në këto grupe janë përfshirë:

- nga pagesa e papunësisë: 20 kursantë
- nga NE: 20 kursantë
- 0-6 muaj: 20 kursantë
- afatgjatë: 20 kursantë
- emigrantë të kthyer: 3 kursantë

### Problematika:

- ❖ Mungesa e ambienteve të punës dhe kushteve jo të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore.

### **8. Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë**

Dega Rajonale Gjirokastrë e Entit Kombëtar të Banesave ka si mision financimin, ndërtimin dhe shitjen e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimin e veprimtarisë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët.

Mbi dorëzimin e apartamenteve për banesa sociale gjatë këtij viti është kryer dorëzimi i 93 apartamenteve në bashkinë Memaliaj, 11 apartamenteve në bashkinë Tepelenë dhe 4 apartamenteve në bashkinë Gjirokastrë.

Lidhur me punën e bërë me klientët debitorë, gjatë këtij viti janë kryer takime me të gjithë klientët debitorë në qytetin e Tepelenës, Memaliaj, Përmetit dhe Gjirokastrës. Janë mbajtur 51 procesverbale takimi, 28 akt-marrëveshje, 89 shkresa njoftimi për detyrim të papaguar, 81 shkresa paralajmëruese për hapje procesi gjyqësor.

### **9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë**

DRSSH ka si mision shërbimin dhe mbështetjen ndaj qytetarëve që kërkojnë shërbim e asistencë teknike; bashkëpunimin institucional për zgjidhjen e problemeve si dhe përgjigjen në kohë e me korrektesë profesionale ndaj çdo kërkesë të DRSSH homologe apo institucioneve shtetërore e private.

DRSSH Gjirokastrë në bashkëpunim, monitorim e reflektim me platformën e bashkëqeverisjes, përmes një organizimi të strukturuar e funksional pune të mirëorganizuar ia ka dalë të reduktojë ndjeshëm duke sqaruar e zgjidhur në afate kohore të gjithë ankimimet, kërkesat, pritshmëritë e qytetarëve duke respektuar ligjin dhe të gjithë udhëzimet e praktikat e dërguara prej ISSH-së.

Detyrat e realizuara gjatë vitit 2019 janë:

- Të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi 103%
- ALSH Gjirokastrë 99%, ALSH Tepelenë 121%, ALSH Përmet 92%
- Ulja e kohës së përpunimit të dosjeve
- DRSSH ka administruar 25.675 pensione prej të cilave 20 362 qyteti, 5 313 fshati dhe 1 person veteran lufte. Dosje të reja për 2019 të cilat sipas përlllogaritjeve janë lidhur me një mesatare prej 18 ditësh, janë 1 578 dosje ku dosje pleqërie janë 1 431; Invaliditeti 64; Familjare 83;

Problematika:

- ❖ Zbatimi me korrektësi i procedurave dhe kohës së lidhjes së pensioneve.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** ka në varësi:

Drejtorinë Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Autoritetin Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Jugor

OSHEE Drejtoria Rajonale Gjirokastrë

**10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor**

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka si mision përmirësimin e efikasitetit të shërbimit ndaj subjekteve shtetërore, private në veprimtarinë e transportit rrugor për regjistrimin e mjeteve motorike, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, pajisjen me leje drejtimi, dhënien e licensave etj; ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve për taksat e palikuiduara të automjeteve ndër vite.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 në D.R.SH.T Rrugor-Gjirokastrë për përgatitjen e kursantëve dhe pajisjen me leje drejtimi automjeti funksionuan 11 autoshkolla të ndara sipas rretheve:

<b>Rrethi</b>	<b>Nr. autoshkollave</b>
Gjirokastrë	6
Tepelenë	3
Përmet	2

Prej autoshkollave janë përgatitur drejtues automjetesh për kategoritë e lejeve të drejtimit: A2, B, C, D dhe CE. Në total për kategoritë e mësipërme të lejeve të drejtimit janë arkëtuar 1251 tarifa. Gjithashtu, ndër shërbimet e tjera të kryera pranë kësaj drejtorie përgjatë vitit 2019 kanë qenë:

<b>Shërbimi</b>	<b>Nr. i shërbimeve</b>
Rinovim leje drejtimi automjeti	1 811
Pajisje me leje drejtimi ndërkombëtare	1 760
Dëshmi taksisti për here të parë	8
Pajisje me leje drejtimi provizore	130

Problematika:

- ❖ Mospagesa e debive të prapambetura për taksat e papaguara të automjeteve prej subjekteve private dhe shtetërore.

## 11. Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Jugor

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër ka si mision ndjekjen, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

Kjo drejtori DRJ Gjirokastër ka patur në inventar 256 km rrugë në qarkun e Gjirokastrës, nga prej të cilave 96 km rrugë i kanë kaluar Bankës Botërore në muajin shkurt 2017. Këto akse rrugore janë aksi Liqeni Krahës-Tepelenë-Gjirokastër-Kakavie dhe aksi rrugor Jorgucat-Qafë Muzinë, të cilat mirëmbahen nga kontrata “C” të Bankës Botërore me kontraktor “Salillari” sh.p.k.

Pjesë e akseve të mirëmbajtjes së kësaj drejtorie përfshihen edhe segmente rrugore më të vogla në gjatësi dhe kryesisht rrugë dytësore. Aktualisht për qarkun Gjirokastër akset që janë të mbuluara me kontrata mirëmbajtjeje 2-vjeçare janë:

- ✓ Aksi rrugor K/Dhuvjan-Libohovë 8 km
- ✓ Aksi rrugor Valare-Erind-Çajup 20 km
- ✓ Aksi rrugor Ura e Leklit-Këlcyrë-Përmet 36 km
- ✓ Aksi rrugor Përmet-Çarshovë-Tre Urat 36 km
- ✓ Aksi rrugor Tepelenë-Kufiri Vlorë/Dorrëz 33.5 km

## 12. OSHEE Drejtoria Rajonale Gjirokastër

OSHEE Drejtoria Rajonale Gjirokastër ka si mision përmbushjen e kërkesave të konsumatorëve për furnizim të pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike nëpërmjet një shërbimi efikas dhe modern.

Në varësi funksionimi të kësaj drejtorie janë 4 Njësi Elektrike (3 njësi shtrihen në juridiksionin e Prefekturës Gjirokastër):

Njësia/Agjencia	Numri i N/ST	Linja TM(km)	Numri i Fiderave	Numri i Kabinave	Numri i Abonentëve
Gjirokastër	3	416.45	19	540	22 778
Përmet	2	308.13	12	234	10 200
Tepelenë	3	399.9	14	264	8 277
<b>Total</b>	<b>8</b>	<b>1 124.48</b>	<b>45</b>	<b>1 038</b>	<b>41 255</b>

Viti 2019 për OSHEE Drejtoria Rajonale Gjirokastër u mbyll me evidencë si më poshtë:

- Janë zëvendësuar në total 73 transformatorë fuqie si pasojë djegieje dhe shtesë fuqie.

Nr.	Njësia /Agjencia	Transformatorë të zëvendësuar
<b>1</b>	Gjirokastër	18
<b>2</b>	Tepelenë	22
<b>3</b>	Përmet	11
<b>Total</b>		<b>51</b>

Treguesit e shërbimit ndaj abonentëve pranë KNK (Kujdesi ndaj Klientit):

Nr.	Lloji i shërbimit	Aplikime të procesuara
1	Ankesa/Kërkesa të ndryshme	7 757
2	Lidhje të reja	1 375

Treguesit ekonomik të OSHEE Drejtorisë Rajonale Gjirokastër për vitin 2019:

Agjencia/Drejtoria	Arkëtime në %	Humbje në %
Gjirokastër	89%	19.1%
Përmet	91%	17.5%
Tepelenë	68%	26.7%
<b>Total</b>	<b>83%</b>	<b>21.1%</b>

Problematika:

- ❖ Rritja e gatishmërisë prej njësave/agjencive në varësi të Drejtorisë Rajonale OSHEE Gjirokastër në raste defekti;
- ❖ Trajtimi me prioritet dhe zgjidhja e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** ka në varësi:

ZVA Gjirokastër-Libohovë-Dropull

ZVA Përmet-Këlcyrë

ZVA Tepelenë-Memaliaj

### 13. ZVA Gjirokastër-Libohovë-Dropull

ZVA Gjirokastër-Libohovë-Dropull ka si mision përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor përmes fuqizimit të rolit të rrjeteve profesionale me fokus promovimin e përvojave më të mira të të nxënimit me bazë kompetencat.

Të dhënat statistikore për numrin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar ZVA Gjirokastër:

Nr.	Arsimi	Arsimi parashkollor		AMU		AML	
		GJ	F	GJ	F	GJ	F
1	PUBLIK	1 142	566	3 276	1 568	1 238	581
2	JOPUBLIK	154	87	501	246	49	12
3	TOTALI	1 296	653	3 777	1 814	1 287	593

Një nga detyrat kryesore të Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional është vlerësimi i cilësisë dhe efektiviteti i shërbimit arsimor në Institucionet e Arsimit Parauniversitar të varësisë. Gjatë vitit 2019, Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, monitoroi në të gjitha IA në varësi të saj (publike dhe private), ku ka kryer monitorime të plota.

- ✓ Institucione Arsimore - 2
- ✓ Orë mësimi të monitoruara - 120
- ✓ Mësues të monitoruar - 60
- ✓ Monitorime të pjesshme - 15

Platforma në të gjitha Institucionet Arsimore.

- ✓ Në MSH 2019 morrën pjesë 473 maturantë
- ✓ Në PKAB 2019 morrën pjesë 319 nxënës
- ✓ Në VANAF 2019 morrën pjesë 334 nxënës

ZVA në bashkëpunim me IA ka zhvilluar veprimtari të ndryshme me karakter kulturor, atdhetar, artistik, mjedisor, sportiv etj për edukimin qytetar të nxënësve.

Buxheti i vitit 2019 është realizuar në masën 87.2%.

#### **14. ZVA Tepelenë-Memaliaj**

ZVA Tepelenë-Memaliaj ka si mision krjimin e një arsimit gjithëpërfshirës, cilësor dhe konkurrues përmes trajnimit dhe fuqizimit të rolit të mësuesit në rrjetet profesionale si dhe përmirësimin të vazhdueshëm të metodave bashkëkohore të të nxënimit me bazë kompetencash.

Gjatë vitit 2019, ZVA Tepelenë-Memaliaj ka realizuar:

- Përditësimin për database e mësuesve sipas përfundimit të kontratave të punës, likuidimit të detyrimeve për mësuesit që shkëpusin marrëdhëniet e punës/dalin në pension.
- Zbatimin e urdhrit nr. 336/2011 “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale” është bërë shpërndarja e praktikantëve dhe vlerësimi i tyre për praktikën profesionale.
- Database e provimeve të shtetit, informimin e kandidatëve me datën dhe ambientet e provimit.
- Është realizuar projekt-buxheti afatmesëm për periudhën 2020-2022.
- Mbështetja për institucionet arsimore në zbatim të kurrikulës së re me kompetencat në arsimin bazë.
- Mbështetja e institucioneve arsimore për zbatimin e strategjive për nxënësit me aftësi të kufizuara, për luftën kundër përdorimit të drogave, duhanit e alkolit, për barazinë gjinore, trafikut të qenieve njerëzore, edukimi mjedisor, sigurimi i fëmijëve në internet etj.
- Monitorimi në procesin e provimeve PKAB dhe MSH 2019.
- Analiza statistikore bazuar në rezultatet e provimeve.



## 15. ZVA Përmet-Këlcyrë

ZVA Përmet-Këlcyrë ka si mision krijimin e një arsimit gjithëpërfshirës, cilësor dhe konkurrues përmes trajnimit dhe fuqizimit të rolit të mësuesit në rrjetet profesionale si dhe përmirësimin të vazhdueshëm të metodave bashkëkohore të të nxënimit me bazë kompetencash.

Të dhënat statistikore për numrin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar ZVA Përmet-Këlcyrë:

Nr.	ARSIMI	Arsimi parashkollor		AMU		AML	
		GJ	F	GJ	F	GJ	F
1	PUBLIK	342	169	1309	606	492	221
2	JOPUBLIK	0	0	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	342	169	1309	606	492	221

Të dhëna statistikore për numrin e mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar ZVA Përmet-Këlcyrë:

ZVA	Arsimi	Nr. total per AMU	Drejtues (dr/nëndr.)	Mësues parashk.	Mësues Asimi Fillor	Mësues Arsimit i Mesëm i Ulet	Nr. total per AML	Drejtues AML	Mësues Arsimit i Lartë	Totali gjithsej
Përmet	Publik	171	8	0	73	98	49	8	41	220

- Nga portali “Mësues për Shqipërinë” janë bërë 11 emëtime provizore (nga të cilët 8 janë mësues ndihmës), deri në përfundim të procesit mësimor dhe 2 zëvendësime raport paaftësie. Gjithashtu, janë emëruar me kontratë të përkohshme 7 mësues, kryesisht të zonave të largëta ose për mungesa të profileve në portal.
- Është bërë në kohë planifikimi, porositja dhe bashkëpunimi me distributorin në shpërndarjen e teksteve shkollore për të gjithë nxënësit. Për vitin 2019 kanë përfituar subvencion 804 nxënës në AMU (Arsim i Mesëm i Ulët) dhe 72 nxënës në AML (Arsim i Mesëm i Lartë) në vlerën totale prej 2 811 789 lekë.
- Gjatë vitit 2018-2019 është bërë rikonstruksioni i plotë i gjimnazit “Sami Frashëri”, Përmet në vlerën totale prej 81 490 378 lekë dhe rikonstruksioni i plotë i gjimnazit “Sejfulla Malëshova”, Këlcyrë në vlerën totale prej 56 713 943 lekë.

**Ministria e Kulturës** ka në varësi:

Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore

### **16. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore**

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore ka si mision ndërhyrjen dhe mirëmbajtjen restauruese në monumente, duke ndërhyrë në fazë të hershme për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të objekteve në gjithë territorin, veçanërisht në qytetin e Gjirokastrës.

DRKK ka realizuar një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme, me vlerë jetike, në objektet monument kulture, si në ato monumente të kategorisë së parë apo të dytë dhe jo vetëm. Gjatë vitit 2019, ka kryer mbi 50 ndërhyrje, nga të cilat mund të përmendim:

- Ndërhyrje emergjente në 6 banesa si “Cano”, “Cani”, “Topulli”, etj.
- Ndërhyrje restauruese në 17 banesa, si “Mezini”, “Demir Demiri”, “Kabilatet”, “Topulli”, etj.
- Ndërhyrje mirëmbajtjeje ambientet e kalasë dhe skenës.
- Ndërhyrje në 3 ura në “Urën e Zerzebilit”, pastrime dhe mirëmbajtje tek “Ura e Tretë e Zerzebilit”.

Gjithashtu, DRKK ka zhvilluar disa aktivitete, të cilat kanë qenë në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin. Kështu gjatë kësaj periudhe janë realizuar 26 aktivitete kulturore-artistike.

Projekte të financuara për vitin 2019 janë:

- Ndërhyrje restauruese në banesën e Andon Z. Çajupi. Vlera e ofruar për restaurim është 4 929 503 lekë.
- Ndërhyrje restauruese në Kroin e Selckës. Vlera e ofruar për restaurim është 1 540 066 lekë. Projekti është financuar nga të Ardhurat e mundësuar nga DRTK Gjirokastrë për vitin 2019. Banesa e Andon Z. Çajupit është realizuar në masën 70% për vitin 2019 dhe përfundon në Janar të vitit 2020. Ndërsa, Kroi i Selckës është realizuar 100%.

Realizimi i të Ardhurave për vitin 2019, totali është 18 135 146 lekë prej të cilave 17 977 146 lekë janë të ardhura nga shitjet e biletave.

#### **Problematika:**

- ❖ Mungesa e specialistëve të mirëmbajtjes dhe fuqisë punëtore.

**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** ka në varësi:

Sektorin e Ekstensionit Bujqësor Gjirokastrë

Sektorin e Bordit të Kullimit Gjirokastrë

Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Drejtoria Rajonale Gjirokastrë

### **17. Sektori i Ekstensionit Bujqësor Gjirokastrë**

Sektori i Ekstensionit Bujqësor ka si mision ngritjen në një nivel më të lartë e cilësor të punës së qendrave të informacionit bujqësor; monitorimin e situatës fitosanitare; nxitjen, inkurajimin, hartimin dhe realizimin e projekteve për skemat e mbështetjes financiare shtetërore dhe ato të IPARD II ose të tjera për bujqësinë; evidentimin e sipërfaqeve të mbjella me kulturat bujqësore dhe hartimin e vjetarit statistikor bujqësor; vrojtimin statistikor gjashtë-mujor dhe vjetor etj.

Gjatë vitit 2019 nga ekstensionistët e SEB Gjirokastrë janë ofruar shërbime si: asistencë teknike për fermerët nëpërmjet funksionimit në kohë të 8 (tetë) qendrave të informacionit bujqësor, të cilat kanë qenë drejtpërdrejt në kontakt me problemet e fermerëve. Gjithashtu, është ofruar asistencën teknike dhe mbështetje lidhur me përdorimin e teknologjive të reja për fermerët.

Përsa i përket kooperimit, nxitjes dhe inkurajimit të grupeve prodhuese dhe ngritjes së tyre deri në nivelin e Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor, pavarësisht punës së bërë prej specialistëve, nuk kanë gjetur vëmendjen dhe përkushtimin e aktorëve të tjerë e si rezultat ende në rajonin tonë nuk kemi SHBB aktive.

Në qarkun Gjirokastrë në 5 skema të mbështetjes së prodhimit bujqësor kanë aplikuar 962 fermerë, nga të cilët 353 në rrethin e Gjirokastrë, 288 në rrethin Tepelenë dhe 321 në rrethin Përmet. Në listën e shpallur nga AZHBR nga qarku Gjirokastrë ishin 499 aplikantë fitues.

Gjithsej janë pajisur me dokumentacionin e duhur për të aplikuar për NIPT bujqësor për vitin 2019, 125 fermerë, ndërsa numri total i fermerëve të pajisur me NIPT ka arritur në 2 337.

#### **Problematika:**

- ❖ Mungesa e testeve paraprake të varieteteve të kulturave bujqësore kryesore që mbillen në rajon si kultivarët e grurit, hibridët e misrit, varietetet e kulturave drufrutore apo të disa specieve të perimeve.
- ❖ Evidentimi i fermerëve potencial në bujqësi e blegtori dhe përsosja e dokumentacionit periodik ana e specialistëve të qendrave të informacionit.

## 18. Sektori i Bordit të Kullimit Gjirokastër

Sektori i Bordit të Kullimit Gjirokastër ka si mision mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Për sa i përket realizimit të investimeve të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2019, investimet kryesore janë: Mbrojtja nga gërryerja nga lumi Kseras, zona Vrisera me vlerë 60 000 000 lekë të reja. Ky investim është tenderuar nga Ministria e Bujqësisë dhe është realizuar 100%.

Për sa i përket masave në drejtim të argjaturave mbrojtëse, KUL, rezervuarit dhe sistemit kullues, Sektori i Bordit të Kullimit Gjirokastër i ka marrë të gjitha masat tekniko-organizative për t'i mbajtur ato në gatishmëri për të përballuar çdo emergjencë të mundshme në raste inondatah. Bordi i Kullimit Gjirokastër disponon vetëm një rezervuar, vetëm atë të Doftisë me kapacitet 16.6 milionë m<sup>3</sup> për të cilin janë marrë të gjitha masat për mbajtjen e tij në gatishmëri teknike.


Po ashtu nga ana e Sektorit të Bordit të Kullimit Gjirokastër në drejtim të mbrojtjes nga gërryerja dhe përmbytja e tokave bujqësore në të tre rrethet, të cilat administrohen prej saj është bërë evidentimi i plotë i tyre, është bërë detajimi i detyrës së projektimit si dhe është përcaktuar vlera paraprake që kërkohet për rehabilitimin e tyre.

## 19. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale Gjirokastër

AKU ka si mision mbrojtjen e konsumatorit; planifikimin, bashkërendimin dhe realizimin e kontrollit zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë dhe të mbrojtjes së bimëve.

- Gjatë vitit 2019 nga sektorët e inspektimit në terren kanë kryer në total 1 632 inspektime, ndërkohë prej sektorëve të inspektimit në PIK Kakavie janë kryer total 6 940 inspektime.
- Mostra të analizuara në Laboratorin Rajonal janë në total 1 340.  
Masa administrative të ndërmarra:
  - ✓ Gjoba 29
  - ✓ Paralajmërimet 206
  - ✓ Mbyllje aktiviteti 4

Vlera totale e gjobave = 8 260 000 lekë.



Në qarkun Gjirokastrë operojnë 290 subjekte që prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë produkte me orgjinë shtazore, të vlerësuar respektivisht:

- ✓ 74 subjekte risk të lartë (RL)
- ✓ 216 subjekte me risk të mesëm (RM)

Problematika:

- ❖ Mosimplementimi i kontrollit efikas në thetore me qëllim disiplinimin e procesit të therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit të tyre.
- ❖ Mosimplementimi i kontrollit efikas në OBU-të e qumështit me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në OBU-të e përpunimit të produkteve të qumështit.
- ❖ Kontrollet për monitorimin dhe parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve zoonotike.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ka në varësi:

Drejtorinë e Spitalit Rajonal Gjirokastrë “Omer Nishani”

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë

Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Gjirokastrë

Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë

**20. Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë “Omer Nishani”**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë ka si mision të mbrojë, të përmirësojë dhe të promovojë shëndetin, produktivitetin dhe mirëqenien e të gjithë njerëzve në qark, duke ofruar shërbime efikase shëndetësore e mjekësore dhe duke u kujdesur për një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik dhe në mjekësi.

Gjatë vitit 2019, në spitalin rajonal “Omer Nishani” janë kryer në total:

- ✓ Operacionet e kryera 563
- ✓ Mamografi 994
- ✓ Rentgenoskopi 1 949
- ✓ Rentgenografi 8 292
- ✓ Ekografi 5 139
- ✓ Scanner 1 535 ku pozitiviteti i përgjigjeve është 60%.
- ✓ Eko Gjinekologjike 1 067

Numri i vdekjeve për vitin 2019 është 64 pacientë.

- Pasqyra e aktivitetit në zbatim të Sistemit të Referimit në Poliklinikën e Specialiteteve për vitin 2019 janë kryer në total 37 637 vizita dhe konsulta.
- Shfrytëzimi i shtratit (plani) në Spitalin Rajonal “Omer Nishani” për vitin 2019 është 31.4 % dhe xhiro shtrati 24.1%.

- Furnizimi me të gjitha mallrat vazhdon pa probleme. Gjatë gjithë vitit 2019 nuk ka patur asnjë mungesë me medikamente apo materiale mjekësore.

Gjatë vitit 2019, Spitali Rajonal Gjirokastrë ka shtuar stafin e lartë mjekësor. Bazuar në kontratën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në spitalin “Omer Nishani” janë emëruar 10 mjekë të rinj specialistë. Përveç specialiteteve ekzistuese në vitin 2019, ekipit të mjekëve specialistë u është shtuar dhe mjekë specialist Anatomo-Patolog dhe Mjek Urgjence.

#### Problematika:

- ❖ Për shërbimin e seancave të dializës është një pamjaftueshmëri fondi prej 24 520 000 lekë që rrjedhimisht ka çuar në rritjen e borxhit në fund të vitit 2019.

### **21. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë**

NJVKSH Gjirokastrë në aktivitetin e saj ka si mision të qartë mbulimin dhe ofrimin me akses të shërbimeve shëndetësore për komunitetin. Vizioni i saj drejtohet në përmirësimin e vazhdueshëm të indikatorëve shëndetësorë dhe të performancës së saj. Kjo veprimtari e integruar nënkupton një aktivitet të koordinuar të shërbimeve dhe sektorëve të drejtorisë sonë, e cila ka si synim:

- Ofrimin dhe mbulimin me akses shëndetësor të shërbimeve mjekësore dhe shëndetësore me cilësi, për të gjithë komunitetin në rajon.
- Monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të KSHP.
- Garantimin dhe ruajtjen e normave optimale të sigurisë së standardeve shëndetësore.
- Rritjen e kapaciteteve menaxhuese të qendrave shëndetësore.
- Ndjekjen e survejllancës epidemiologjike të sëmundjeve dhe monitorimin e indikatorëve të higjienës mjedisore
- Informimin dhe edukimin shëndetësor të popullatës për rrisqet dhe rreziqet shëndetësore.
- Promovimin e një stili të shëndetshëm jetese, si marrjen e masave mbrojtëse dhe parandaluese.

Në juridiksionin e NJVKSH në rrethin e Gjirokastrës numërohen 13 QSH në njësitë administrative dhe 10 ambulanca në lagjet e qytetit, si dhe 72 ambulanca në fshatra, të cilat përfaqësojnë sistemin kapilar të KSHP. Në këto institucione shëndetësore shërbejnë përkatësisht 22 mjekë familjeje dhe 147 infermierë.

Të gjitha QSH janë në funksionalitet të plotë së bashku me 98% të ambulancave të fshatrave, të cilat përfaqësojnë sistemin kapilar të KSHP. Shërbimet shëndetësore ofrohen në të gjitha QSH të rrethit Gjirokastrë duke mbuluar kështu nevojat individuale dhe komunitare të popullatës me kujdes shëndetësor.

Në funksion të shërbimit shëndetësor dhe ofrimit të tij ndaj popullatës kemi 13 Qendra Shëndetësore T-1 dhe T-2, të cilat janë në funksionalitet të plotë dhe 72 Ambulanca A-1 dhe A-2, nga të cilat 12 prej tyre nuk janë funksionale, për shkak të amortizimit të tejskajshëm.

Veprimtaria në punë e qendrave shëndetësore dhe aktiviteti në tërësi i shërbimit të KSHP në bashkinë Gjirokastrë, Dropull dhe Libohovë paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr.	Indikatorët dhe treguesit	Totali	Qytet	Fshat
1.	Numri i vizitave në të gjitha QSH	72 259	53 351	18 908
2.	Numri i vizitave 0-14 vjeç	9 205	8 124	1 081
3.	Numri i vizitave mbi moshën 14 vjeç	62 694	45 208	17 486
4.	Numri i vizitave në banesë	360	19	341
5.	Numri i vizitave në ambulanca	10 746	0	10 746
6.	Numri i recetave elektronike	28 220		
7.	Numri i referimeve elektronike	13 662		

Evidenca që pasqyron aktivitetin e QSH dhe Ambulancave të NJVKSH Gjirokastrë.

#### Problematika:

- ❖ Shërbimi shëndetësor në QSH Zagorie, Pogon, Picar, Cepo, Lunxhëri, Antigone, Dropulli i Sipërm, shpesh shihet si problematikë pasi ndikojnë disa faktorë si largësia e këtyre zonave të thella rurale, terreni i thyer dhe i vështirë, bllokimi i rrugëve në dimër, si pasojë e rreshjeve të shiut dhe dëborës duke krijuar vështirësi në ofrimin e ndihmës së parë, sidomos në situata emergjente.
- ❖ Në disa QSH të zonave të thella nuk ka personel resident në ambulancat e fshatrave dhe shërbimi mbulohet prej infermierëve gjatë orarit zyrtar të punës 08-14.40 që vijnë nga qyteti apo zona të tjera, ndërkohë që pas këtij orari shërbimi ngelet disi i pa mbuluar.
- ❖ Përmirësim nevojitet në sistemin e informacionit shëndetësor, i cili duhet të jetë më i strukturuar dhe i unifikuar, bazuar në matjen reale të indikatorëve shëndetësorë dhe mjekësorë. Njëkohësisht kjo gjë duhet të shoqërohet me trajnimin e personelit për njohjen dhe aplikimin e programeve dixhitale mjekësore për hedhjen e saktë të të dhënave dhe përcjelljen e tyre në kohë reale.
- ❖ Nevojitet më shumë punë dhe një këndvështrim realist për akreditimin institucional të QSH, të cilat duhet të ofrojnë shërbime shëndetësore me cilësi, siguri dhe standarde profesionale.

## **22. Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Gjirokastrë**

Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ka si mision garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik; mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshme të personave fizikë e juridikë në mbrojtje të shëndetit publik.

Kjo degë rajonale ka realizuar 1 079 inspektime dhe 128 riinspektime, 1 143 monitorime si dhe janë marrë 20 masa administrative me vlerë 4 660 000 lekë në qarkun Gjirokastrë dhe 5 masa administrative në funksion të taks forcës të ngritur nga I.SH.SH. Qendror me vlerë 920 000 lekë.

Janë lëshuar 198 akt-miratim higjeno-sanitare dhe të ardhurat nga këto akt-miratime kapin vlerën e 779 000 lekë, si dhe janë arkëtuar nga masat administrative 101 000 lekë.

Plani i buxhetit të vitit 2019 i miratuar për I.SH.SH. Qarku Gjirokastrë, ka qenë 16 000 lekë (plani), fakti (13 741) dhe realizimi është 85 %.

Problematika:


- ❖ Edhe pse prej kësaj drejtorie janë marrë masa konkrete për parandalimin e konsumit të duhanit, në disa subjekte private vazhdon të konsumohet duhan në ambientet e brendshme të tyre.

**23. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë**

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë ka si mision garantimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilat nuk mund të plotësojnë nevojat bazë jetike.

Bazuar në të dhënat administrative të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, në fund të vitit 2019 kishte 991 aplikime prej të cilëve 815 përfitues. Sipas ecurisë vjetore të nr. të aplikimeve mbi 80% e individëve rezultojnë përfitues. Krahasuar me vitin 2018 vihet re një rënie e familjeve përfituese me 3%.


Për vitin 2019 fondi i celur për trajtimin e familjeve të Ndhmës Ekonomike është 3 milionë lekë më i lartë krahasuar me vitin 2018.



- Viti 2018: 56.7 milionë lekë
- Viti 2019: 59.7 milionë lekë.

*(grafiku tregon fondin për pagesën e NE në vitin 2018 dhe 2019)*

Ecuria vjetore e aplikimeve  
Janar –Dhjetor 2019





Për të rritur bazën e mbështetjes, për familjet në nevojë, një pjesë e aplikantëve – jo përfitues nga sistemi, kanë të drejtë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%, mbi bazën e kriterëve të vendosura nga Këshillat Bashkiakë.

Disa nga bashkitë e qarkut me më shumë problematika sociale planifikuan për vitin 2019 fonde sociale për familjet/individët, të mbetura jashtë skemës së ndihmës ekonomike dhe fondit 6%, duke maksimizuar në këtë mënyrë numrin e familjeve të mbështetura me ndihmën ekonomike. Gjatë vitit 2019 sipas evidencave janë përdorur këto fonde:

<b>Bashkia</b>	<b>Fondi 6%</b>	<b>Fondi i bashkisë</b>
<b>Gjirokastrë</b>	156 460	331 800
<b>Libohovë</b>	30 240	74 000
<b>Tepelenë</b>	649 800	623 700
<b>Memaliaj</b>	921 950	
<b>Përmet</b>	145 690	267 300
<b>Këlcyrë</b>	505 645	
<b>Dropull</b>	80	

#### Problematika:

- ❖ Mosrespektimi i afateve ligjore të mbledhjeve të këshillave bashkiakë e si rrjedhojë pagesa e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë bëhet me vonesë.

#### Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka në varësi:

Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura

Degën Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit

Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Gjirokastrë

Në zbatim të politikave kombëtare për Turizmin si një ndër sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të qarkut, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, është ndjekur ecuria e sezonit turistik 2019, ku konkretisht janë regjistruar 172 629 turistë, që paraqiten si më poshtë:

- ✓ Bashkia Gjirokastrë 112 129 vizitorë
- ✓ Bashkia Dropull 7 500 vizitorë
- ✓ Bashkia Libohovë 9 000 vizitorë
- ✓ Bashkia Tepelenë 17 000 vizitorë
- ✓ Bashkia Memaliaj 2000 vizitorë
- ✓ Bashkia Përmet 20 000 vizitorë
- ✓ Bashkia Këlcyrë 5 000 vizitorë

<b>Bashkitë e qarkut</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2019</b>
Gjirokastrë	114 278	112 129
Dropull	4 500	7 500
Libohovë	9 200	9 000
Tepelenë	8 000	17 000
Memaliaj	1 000	2 000
Përmet	26 000	20 000
Këlcyrë	1 517	5 000
<b>Totali:</b>	<b>164 495</b>	<b>172 629</b>

Pra, shohim një tendencë në rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj krahasuar me vitin 2018 me 4.5%.

#### **24. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura**

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme edukimin mjedisor të komunitetit. E gjithë kjo veprimtari është kryer në bashkëpunim me pushtetin vendor, Zyrën Vendore Arsimore Gjirokastrë dhe Përmet, shoqata dhe organizata të ndryshme.
- Është përmirësuar infrastruktura e zonave të mbrojtura nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese dhe orientuese.
- Janë ushtruar kontrole të përbashkëta me Sektorin e Monitorimit të Zonave të Mbrojtura në drejtim në zbatimin të ligjshmërisë për menaxhimin, mbrojtjen e florës dhe faunës, mbrojtjen nga zjarri si dhe në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.
- Janë specifikuar 6 lloje shpendësh në rezervuarin e Bulos.
- Janë monitoruar speciet e rralla në rrezik zhdukje në Glinë dhe Nivicë.
- Është punuar për Planin e Mbarështimit të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, rishikimin e sipërfaqeve të ZMM dhe krijimin e pasaportës turistike për zonat e mbrojtura në qarkun tonë.
- Në bashkëpunim me Fondin Shqipat të Zhvillimit po punohet për hartimin e një projekti për përmirësimin e infrastrukturës në “Ujërat Termale Bënjë”.
- U implementuan në terren të gjitha procedurat tekniko-ligjore për punimet rehabilituese dhe shëndetësuese të pyjeve.
- Janë lidhur 68 kontrata me fermerë që mbarështojnë blektorinë në ZM, duke realizuar kështu një të ardhur prej 2 621 860 lekë.
- Në kuadër të ruajtjes së zonave të mbrojtura janë realizuar 265 kontrole të përbashkëta, me synim parandalimin e çdo veprimtarie të paligjshme. Prej kontrolleve janë konstatuar 2 raste të veprimtarive të paligjshme.

Në shërbim të zhvillimit të turizmit u zhvillua projekti “Smile Albania”, ku AdZM organizoi punën për zgjedhjen e të rinjve dhe trajnimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe u punësuan 39 të rinj dhe u ngritën 4 pika informimi prej tyre me qëllim dhënien e informacionit të kërkuar prej turistëve dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve.

Për periudhën Janar-Dhjetor kanë vizituar Zonat e Mbrojtura 52 305 turistë nga të cilët 38 394 turistë vendas dhe 13 911 turistë të huaj.

#### Problematika:

- ❖ Infrastruktura jo e mirë e zonave të mbrojtura si dhe zhvillimi i veprimtarive të paligjshme në zonat e mbrojtura.

### **25. Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit**

Dega Rajonale e ISHMPUT Gjirokastrë ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve dhe ujërave; evidentimin e subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtari me ndotje në mjedis, pajisjen e tyre me leje mjedisore dhe zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.

Spektori i Inspektimit Mjedisor ka kryer gjithsej 80 inspektime nga të cilat vetëm një është proceduar me masë administrative për ndotje akustike. Gjithashtu janë kryer kontrole në subjektet të cilat gjenerojnë mbetje spitalore si klinika dentare, laboratore analizash etj.

Spektori i Inspektimit të Ujërave për periudhën janar – dhjetor 2019 ka kryer gjithsej 86 inspektime, nga të cilat vetëm në një subjekt është vendosur dënim administrativ. Nga ky sektor janë dërguar 100 njoftime zyrtare tek të gjithë përdoruesit e rezervave ujore dhe personave fizik/juridik të cilët janë përdorues të ujërave nëntokësore, në mënyrë që të kryejnë vetëdeklarimet pranë zyrave të administrimit të baseneve ujore.

Janë kryer verifikime në terren për gjendjen e shfrytëzimit të materialeve inerte lumore përgjatë shtretërve të lumenjve Drino dhe Vjosë.

Spektori i Policisë Pyjore sipas autorizimeve të dhëna, përgjatë periudhës janar – dhjetor ka kryer gjithsej 272 inspektime duke vendosur 11 masa administrative.

Janë kryer kontrole në karerat e gurit për verifikim dokumentacioni, kontrole në parcelat pranverore dhe inspektime në ngastra të ekonomive të ndryshme pyjore të cilat janë pika të nxehta për prerje të lëndës drusore sipas Urdhrit të Brendshëm datë 18.01.2019.

Gjithashtu, në bashkëpunim me institucionin e Prefektit të qarkut, Policinë Vendore dhe AdZM është punuar në kuadër të fushatës kundër kultivimit të bimëve narkotike.

### Problematika:

- ❖ Mos pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe ndalimi i shfytëzimit, në segmente të ndryshme të lumenjve Vjosë, Drino e degëve të tyre, ku ka akumulime të mëdha sasish të materialeve inerte.

## **26. Drejtoria Rajonale e Mjedisit Gjirokastrër**

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Gjirokastrër ka si mision lëshimin e lejeve mjedisore; grumbullimin e të dhënave për gjendjen mjedisore në qark dhe mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane në njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut.

Për vitin 2019 nga ana e kësaj drejtorie janë realizuar objektivat e punës si:

Ndjekja e tarifave në mënyrë progresive çdo muaj, mbi bazën e akt-rakordimit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Vjelja e pagesave të tarifave vjetore të lejeve mjedisore është realizuar në masën 100% e totalit të subjekteve të regjistruar në regjistrat e lejeve.

Kryerja në afatet e kërkuara të raporteve të monitorimit, hedhja e të dhënave në Raportin e Gjendjes Mjedisore (RGJM) si dhe ndjekja e raportimeve në bashkëpunim me subjektet dhe ISHMPUT.

Zgjidhja në kohë e ankesë-kërkesave të komunitetit në lidhje me menaxhimin e ndikimit të ndotjeve të shkaktuar në komunitet.

Monitorimi i mbetjeve të rrezikshme dhe NOQ, punuar me modelin e regjistrat për gjeneruesin e vajrave.

Mbajtja e regjistrat të subjekteve për leje mjedisore të tipit C (20 aplikime, 20 akt-miratime, 0 akt-refuzime), 12 subjekte për mendim leje mjedisore tipi A/B, 11 subjekte për mendim VNM-je dhe 2 subjekte për transferim leje mjedisore tipi C.

Informimi rregullisht i ISHMPUT Gjirokastrër për problematikat lidhur me detyrimet e subjekteve në zbatim të kushteve të lejes dhe detyrimeve ligjore.

#### **IV. Investimet kryesore në qarkun Gjirokastrë**

Në kuadër të zhvillimit ekonomik të rajonit, Qeveria Shqiptare ka akorduar fonde për realizimin e një sërë investimesh, të cilat kanë pasur një impakt të rëndësishëm në jetën sociale dhe ekonomike të banorëve të qarkut Gjirokastrë.

Konkretisht, me fonde nga buxheti i shtetit apo donatorë të tjerë, janë prokuruar dhe janë në proces një sërë projektesh të cilat konsistojnë në: përmirësim të infrastrukturës rrugore, rehabilitim urban, shëndetësi, arsim, turizëm etj.

##### **Disa nga projektet më kryesore të përfunduara janë:**

- Rehabilitim i infrastrukturës dhe restaurim i kalldrëmeve në Pazarin e Gjirokastrës në vlerën 137 milionë lekë.
- Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Asim Zeneli” + sistem i jashtëm në vlerën 83 milionë lekë.
- Rehabilitimi i zonës së dëmtuar nga rrëshkitja masive në Kodrën e Shtufit.
- Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi” Libohovë në vlerën 65 milionë lekë.
- Shkolla e mesme “Sami Frashëri” Përmet në vlerë 85 milionë lekë.
- Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Sejfulla Malëshova” bashkia Këlcyrë në vlerën 56 milionë lekë.

##### **Projekte në vazhdim janë:**

- By Pass-i Tepelenë me një fond prej 2.8 miliardë lekë.
- Aksin Rrugor Kardhiq-Delvinë me vlerë të projektit 41 milionë dollarë.

## V. Mbrojtja Civile

**M**bi bazën e planit vjetor të miratuar, në të cilin janë parashikuar dhe planifikuar të gjitha detyrat e institucionit, të shtrira sipas muajve por edhe sipas specifikave të emergjencave të pritshme që e karakterizojnë territorin e qarkut Gjirokastrë bazuar edhe në përvojën e krijuar në vitet e shkuara, veprimtaria e institucionit të Prefektit në drejtim të mbrojtjes civile është fokusuar në marrjen e masave për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë dhe përgjigjen për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë e tjera me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, trashëgimisë kulturore si dhe mjedisit.

Për këtë janë organizuar mbledhjet e KECQ “Për marrjen e masave për përballimin e situatave të mundshme të shaktuara nga përmbytjet”. Janë hartuar dhe abdetuar: Plani i Përballimit të Emergjencave në nivel Qarku; Plani Evakuimit; Plani i Gatishmërisë me skenar për zolim nga dëbora dhe përmbytjet; Plani i bashkëpunimit të strukturave monitoruese, vepruese dhe operacionale dhe janë përditësuar pikat e kontaktit, mënyrat e marrjes së informacionit dhe shkëmbimin e ndërsjellë me të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

Janë përcaktuar dhe evidentuar burimet dhe kapacitetet njerzore dhe logjistike që disponon qarkut dhe çdo drejtori në nivel qendror dhe lokal si dhe janë përcaktuar parashikimet e dëmeve të mundshme në dy skenarët (Izolimi nga dëbora dhe Përmbytjet), janë përcaktuar kërkesat për mbështetje logjistike nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.

I është kushtuar vëmendje ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe koordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga rreshjet e shiut, dhe të dëborës, si dhe të emergjencave verore. Është bashkëpunuar dhe inspektuar në bashkëpunim me Autoritetin Jugor të Rrugëve për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së kësaj strukture në hapjen e akseve nacionale në të gjithë territorin e qarkut.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për mbrojtjen civile” del si domosdoshmëri riorganizimi i strukturave të mbrojtjes civile pranë bashkive dhe strukturave të degëve territoriale me qëllim menaxhimin me efikasitet të situatave të pritshme në të gjithë territorin e qarkut. Me këtë rast kërkohet rritja e kapaciteteve njerzore dhe logjistike për përballimin e situatave emergjente të shaktuara nga përmbytjet, zjarri dhe katastrofat natyrore si dhe rritja e bashkëpunimit me organet e policisë së shtetit, për të bërë të mundur zbulueshmërinë e rasteve të zjarrvënies së qëllimshme.

Hartimi i Planeve të Përballimit, planeve të lajmërimit të hershëm nga çdo bashki është detyrë imediate ligjore dhe duhet të parashikohen sanksione ligjore për personat përgjegjës të strukturave emergjente pranë cdo bashkie në rastet e mos hartimit të tyre në kohën e parashikuara me Ligj.

## **VI. Task Forcat, Komitetet Rajonale si dhe Organi Këshillues pranë Prefektit të qarkut**

**B**azuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e qarkut”, ligjin nr. 8576, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, dhe VKM-se Nr. 655, datë 18.12.2003 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”, me urdhër të Prefektit nr. 12, datë 25.01.2019, është ngritur dhe ka funksionuar Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel qarku. Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë gjatë vitit 2019 ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha situatat emergjente të krijuara në qarkun tonë si rezultat i kushteve të vështira atmosferike në stinën e dimrit apo të verës. Janë marrë masat për të bashkërenduar punën mes institucioneve qendrore në nivel vendor dhe organeve të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Në zbatim të shkresës së Ministrisë të Punëve të Brendshme datë 15.06.2016 “Për marrjen e masave në përballimin e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe informim”, me urdhër të Prefektit të qarkut është ngritur Task- Forca Rajonale për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës 2019 me përbërje drejtuesit e vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të veçanta të institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, bazuar në Plan Veprimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike gjatë vitit 2019”, pranë këtij institucioni me urdhër të Prefektit të Qarkut është ngritur Taks forca vendore e Luftës Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit. Shtabi Rajonal gjatë vitit 2019 ka zhvilluar disa takime dhe ka bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore në nivel vendor duke përmendur këtu edhe grupet e punës. Institucioni i Prefektit të qarkut ka raportuar çdo javë në Task Forcë qendrore në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e Task Forcës Vendore.

Bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2014 – 2017 (miratuar me VKM 814, datë 26.11.2014) dhe në Urdhërin. nr. 139, datë 19.06.2006 i Kryeministrit për “Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, pranë këtij institucioni është ngritur Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për Qarkun e Gjirokastrës. Ky komitet ka zhvilluar rregullisht dhe në mënyrë periodike mbledhjet e tij si dhe ato të Tryezës Teknike Rajonale.

Në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 39, datë 28.02.2018 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2019 dhe ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, Task-Forcë për menaxhimin e sezonit turistik veror 2019” është ngritur dhe ka zhvilluar takimet periodike “Komitetit Rajonal i Zhvillimit të Turizmit”, për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2019.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 593, datë 19.10.2018 “Për përbërjen, funksionimin, detyrat e përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore” dhe në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e qarkut” është ngritur Komiteti Rajonal i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, i cili ka funksion mbikëqyrës për zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura mjedisore dhe programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme sipas kërkesave të tij. Mënyra e funksionimit të këtij komiteti është përcaktuar në rregulloren e miratuar nga anëtarët e komitetit.

Janë zhvilluar rregullisht sipas kalendarit vjetor të miratuar mbledhjet e Organit Këshillues të Prefektit duke trajtuar temat e përcaktuara në tematikën vjetore. Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësisë nga ana e Prefektit janë zhvilluar takime të shumta, përfshirë edhe takimet e grupit këshillues pranë Prefektit (sipas fushave dhe sektorëve të veprimtarisë), takime në formë të përmbledhur, sipas çështjeve të trajtuara.

Siç u prezantua më sipër, këto Task-Forca, Komitete apo Organi Këshillues kanë funksionuar normalisht, por vlen të theksohet se jo gjithmonë janë zbatuar rekomandimet e dala pas takimeve të tyre. Gjithashtu, duhet të theksojmë se pavarësisht se pjesëmarrja e drejtuesve të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe degeve territoriale në këto Task-Forca është detyrim ligjor, në jo pak raste drejtuesit nuk kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Prefekti i qarkut, gjë që lidhet me moszbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të dala në këto takime. Në këtë kuadër do të kërkoja rritjen e angazhimit dhe përgjegjësisë suaj në këtë drejtim.



## VII. Rekomandime

**M**e qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe performancës në çështje, të cilat kërkojnë përkushtim dhe angazhim nga të gjitha strukturat, dua të rendit disa rekomandime, si më poshtë:

- ❖ Respektimin e afateve kohore në raportimin periodik mujor të arritjeve dhe problematikave nga ana e çdo institucioni.
- ❖ Përgatitja e planeve vjetore në përputhje me ligjin e ri “Për mbrojtjen civile” dhe dërgimi i tyre pranë institucionit të Prefektit brenda muajit shkurt 2020.
- ❖ Evidentimin e problematikave të gjendjes fizike të godinave të institucioneve shtetërore dhe planifikimin e masave në rastet e emergjencave civile.
- ❖ Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral si dhe shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.
- ❖ Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.
- ❖ Zbatimi i kërkesave formale në hartimin e akteve e shkresave sipas modeleve të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nga të gjithë institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- ❖ Rritja e bashkëpunimit midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektoriateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënie e qëllishme, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.
- ❖ Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile si dhe me shoqata mjedisore për krijimin e një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut.

## VIII. Objektivat për vitin 2020

**N**gritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku (Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit).
2. Përballimi i situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, apo nga faktor të tjerë (Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjerë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente).
3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale, si dhe fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën; Goditja dhe shkatërrimi i kultivimit të kanabisit, duke e nxjerrë përfundimisht qarkun Gjirokastrë nga harta e kultivimit; Sigurimi i rendit publik (Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese).
4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve, nëpërmjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (Bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim).
5. Goditja e informalitetit dhe zgjidhja e qëndrueshme në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm (Bashkërendimi i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshi shoqëritë aksionere të UK).
7. Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga ana e Drejtorisë Rajonale të OShEE Sh.A; Përmirësimi i treguesve ekonomiko-financiar dhe performancës; Ulja e nivelit të humbjeve në kufijtë e pranueshëm (Bashkëpunimi, koordinimi i veprimtarisë së institucioneve rajonale, njësitë të vetëqeverisjes vendore me Degën Rajonale të OSHEE Gjirokastrë, si dhe monitorimi i veprimtarisë).